REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

KRYETARI I BASHKISË

Nr.3153/1 Prot Maliq, më 01.07.2024

NJOFTIM PUBLIK

Në mbështetje të nenit 9, pika 1.2, gërma "a", neni 64, gërma "a", të Ligjit Nr. 139/2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" i ndryshuar, Ligjit Nr. 8312 datë 26.03.1998 "*Për Tokat Bujqësore të Pandara*", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.826, datë 21.11.2012 "*Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Pirg të Qarkut të Korçës*", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.531, datë 21.08.1998 "*Për Tokat Bujqësore të Pandara*", Udhëzimit Nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave "*Për proçedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara*", Kreu I pika 5, Kreu II pika 1 dhe 3, si dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 97, datë 27.11.2020 "*Për miratimin e fillimit të procedurës për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara, Nr.373 dhe 374/6, Zk 1900, Gurishtë, Njësia Administrative Pirg, Bashkia Maliq*",

Bashkia Maliq, njofton se jep me qira tokën bujqësore të pandarë me ligjin Nr. 7501, datë 19.07.1991 "*Për Tokën*", me Numër Pasurie 374/6, Zonë Kadastrale 1900, Sipërfaqe 70 850 m^2, fshati Gurishtë, Njësia Administrative Pirg.

Të interesuarit të paraqesin kërkesat e tyre pranë Bashkisë Maliq, brenda datës **10.07.2024.**

Kërkesa për marrjen me qira duhet të jetë e shoqëruar me dokumentacionin e përcaktuar në Kreun II, pika 1 të Udhëzimit Nr.1, datë 18.07.2012.

Ankandi për dhënien e tokës me qira do të zhvillohet në datën **18.07.2024,** ora **10:00**, në ambjentet e Bashkisë Maliq.

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim Topçiu

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ